



BULETINI PERIODIK

NR. 2



TË DHËNA NGA DINAMIKA E TREGUT AUDIOVIZIV NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(Korrik - Dhjetor 2016)

01. Aspekte ekonomike të tregut audioviziv

1. Renditja e OSHMA-ve sipas treguesve kryesorë ekonomikë
 - 1.1 Sipas totalit të të ardhurave vjetore
 - 1.2 Sipas rezultatit ekonomik
 - 1.3 Sipas nivelit të taksave të paguara (taksapaguesit më të mëdhenj)
 - 1.4 Sipas nivelit të aseteve fikse
2. Paraqitja grafike e rezultatit ekonomik dhe vlerës së aseteve fikse
 - 2.1 Shpërndarja e OSHMA-ve sipas rezultatit ekonomik
 - 2.2 Shpërndarja e OSHMA-ve sipas aseteve fikse

02. Pronësia në aktivitetin audioviziv dhe kontributi jashtë tregut

3. E drejta dhe kufizimet e pronësisë për OSHMA-të
 - 3.1 Strukturimi pronësor në tregun audioviziv
 - 3.2 Përqendrimi i kontributorëve të OSHMA-ve në degë të ndryshme të industrisë

03. Karakteristika të personelit të angazhuar në OSHMA-të

4. Strukturimi i stafeve sipas nivelit arsimor, moshës, vjetërsisë në punë, gjinisë dhe profesioneve.
 - 4.1 Arsimimi i punonjësve
 - 4.2 Mosha
 - 4.3 Vjetërsia në punë
 - 4.4 Balanca gjinore
 - 4.5 Struktura sipas profesioneve
5. Trajtimi i personelit në raport me të ardhurat dhe shpenzimet
 - 5.1 Strukturimi i pagave sipas ndarjes në profesione të stafit
 - 5.2 Përqendrimi i personelit të OSHMA-ve sipas nivelit të pagës
 - 5.3 Raporti i pagave mbi të ardhurat dhe shpenzimet vjetore totale

04. Treguesit teknikë të transmetimit të OSHMA-ve



6. Plani frekuencor numerik
7. Mbulimi me sinjal i OSHMA-ve sipas territorit dhe popullatës
 - 7.1 Paraqitja e hartave gjeografike për subjektet kombëtare
 - 7.2 Mbulimi sipas qarqeve
 - 7.3 Mbulimi sipas numrit të popullatës
 - 7.4 Përqendrimi i televizioneve sipas kohës ditore të transmetimit
8. Prezenca e OSHMA-ve në Kosovë e Maqedoni

05. Aspekte të monitorimit të përmbatjeve të transmetuara



9. Edicionet kryesore informative të OSHMA-ve kombëtare
10. Reklammat dhe komunikimet tregtare
 - 10.1 Volumi i reklamave dhe komunikimeve tregtare
 - 10.2 Blerësit kryesorë të kohës televizive në televizionet kombëtare

06. Shtojcat



12. Të dhëna nga përmbajtjet e edicioneve kryesore informative të OSHMA-ve kombëtare
13. Të dhëna të përgjithshme të OSHMA-ve

VIJUESHMËRIA E PUBLIKIMIT TË BULETINIT PERIODIK TË AMA-S

Edicioni i parë i Buletinit u mirëprit nga të interesuarit.

Në rradhë të parë nga vetë OSHMA-të, por dhe nga studiuesit e monitoruesit e tregut audioviziv, pedagogët dhe studentët e gazetarisë dhe komunikimit, kompanitë reklamuese të shërbimeve dhe produkteve, institucionet dhe organizatat vendase dhe të huaja, që janë të fokusuar në dinamikën e zhvillimit të medias, statisticienë, por dhe lexues të thjeshtë hobistë – të gjithë kanë gjetur në atë numër premierë një fluks treguesish konkretë nga performanca e operatorëve audio dhe audiovizivë në Shqipëri.

Të dhënat e edicionit të parë të Buletinit, (01.01.2016 – 30.06.2016), jo vetëm janë komentuar, por menjëherë u bënë referencë për raportime dhe studime institucionesh dhe subjektsh publike dhe jopublike, detyra kursi dhe punime diplomash nga studentët e të gjitha niveleve universitare, si një tregues për dobishmërinë e tyre dhe nevojën e domosdoshmërinë e publikimit sistematik, me përgjegjësi dhe profesionalizëm, çdo gjashtë muaj.

Drejtoria e Programeve në Autoritetin e Mediave Audiovizive, AMA, pas botimit të edicionit të parë më shumë ishte e interesuar për pjesën e vërejtjeve dhe sugjerimeve për këtë produkt të ri. Me vëmendjen dhe kujdesin maksimal për të reflektuar çdo propozim dhe mendim që shkon për përmirësimin dhe standardizimin e ofertës, për të qenë sa më precizë dhe të qartë në prezantimin shumëplanësh të pejzazhit audioviziv shqiptar.

Tani që, online apo në print, shfletoni edicionin e dytë të Buletinit Periodik të AMA-s, (01.07.2016 – 31.12.2016), ju jepet mundësia që jo vetëm të shikoni parametrat e tregut për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2016, por dhe të shqyrtoni në mënyrë krahasuese situacionet në të dy periudhat, ndryshimet, trendet, prirjet.

Kjo do të jetë edhe më e efektshme kur lexuesi do të ketë në dorë dhe edicionet e tjera vijuese të këtij Buletini.
Lexim të mbarë!

Autoriteti i Mediave Audiovizive

1. Renditja e OSHMA-ve sipas treguesve kryesorë ekonomikë

1.1 Sipas totalit të të ardhurave vjetore për 2016-ën¹

■ Televizione

Nr.	Subjekti	Të ardhurat
01.	RTSH.....	2.168.407.004
02.	Top Channel.....	1.605.657.431
03.	Klan.....	1.264.843.699
04.	Vizion Plus.....	470.612.631
05.	News 24.....	260.202.359
06.	Ora News.....	187.839.422
07.	ABC News.....	177.605.681
08.	Scan.....	123.271.090
09.	Report Tv	116.037.788
10.	In Tv.....	109.252.832

■ Radio

Nr.	Subjekti	Të ardhurat
01.	City Radio Albania.....	62.172.178
02.	Top Albania Radio.....	61.369.890
03.	Club FM.....	48.452.675
04.	In.....	28.674.252
05.	Energy.....	28.203.513
06.	MCN.....	19.155.990
07.	Radio 7	18.457.820
08.	Radio 1.....	16.810.560
09.	Love.....	16.414.488
10.	Radio Maria.....	15.531.887

¹ Nëse në Edicionin e parë të këtij Buletini referencat e këtij kapitulli ishin nga bilanci i OSHMA-ve për vitin 2015, për këtë gjashtëmujor referencat janë nga bilanci i vitit 2016.

■ Kabllorë

Nr.	Subjekti	Të ardhurat
01.	ABCom.....	1.816.479.807
02.	J & Pro.....	223.225.755
03.	Tele Co.....	51.577.446
04.	Inkusat.....	43.254.470
05.	Sky Elbasan.....	32.772.107
06.	Elbasan Cable.....	32.772.107
07.	Korca TV Lobi.....	29.874.816
08.	Best Cable.....	26.057.963
09.	Kukësi.....	18.738.416
10.	Bulqiza.....	13.701.478

■ Shërbime të tjera

Nr.	Subjekti	Të ardhurat
01.	Albtelecom.....	9.233.720.000
02.	Digitalb.....	5.682.437.809
03.	Abcom 3n1.....	1.816.479.807
04.	Tring.....	977.894.750
05.	Abissnet.....	426.396.901
06.	Nisatel.....	375.758.264
07.	Digicom.....	277.749.491
08.	Tibo Tv.....	187.191.264
09.	Bleta Tv.....	73.610.754
10.	Next Tv.....	45.807.861

1.2 Sipas rezultatit ekonomik të vitit 2016

■ Televizione

Nr.	Subjekti	Rezultati ekonomik
01.	Klan.....	292.941.310
02.	RTSH.....	238.697.784
03.	Ora News.....	27.408.984
04.	ABC News.....	24.298.141
05.	Vizion Plus.....	21.193.555
06.	Top Channel.....	11.042.902
07.	News 24.....	9.066.598
08.	Channel One.....	7.261.325
09.	Star Plus.....	3.782.700
10.	Report TV.....	2.935.871

■ Radio

Nr.	Subjekti	Rezultati ekonomik
01.	City Radio Albania.....	16.040.442
02.	Energy.....	8.132.199
03.	Radio 1.....	6.778.815
04.	Love.....	6.581.140
05.	Club FM.....	6.027.998
06.	Living.....	4.020.851
07.	DJ 96,1.....	2.088.169
08.	In.....	1.930.424
09.	Alpo.....	1.702.716
10.	Radio Top Albania.....	1.443.976

■ Kabllorë

Nr.	Subjekti	Rezultati ekonomik
01.	ABCom.....	374.636.267
02.	Inkusat.....	18.538.773
03.	Sky Elbasan.....	5.612.475
04.	Elbasan Cable.....	5.612.475
05.	Best Cable.....	3.612.966
06.	Aral.....	3.353.113
07.	Ergi.....	2.596.697
08.	M.Devolli.....	2.509.980
09.	Tele Co.....	2.063.098
10.	Andor.....	1.930.080

■ Shërbime të tjera

Nr.	Subjekti	Rezultati ekonomik
01.	Albtelecom.....	3.220.683.000
02.	ABCom 3N1.....	374.636.267
03.	Digitalb.....	158.940.451
04.	Nisatel Tv	75.472.187
05.	Abissnet	18.343.108
06.	Next tv.....	7.315.492
07.	Bleta Tv.....	4.965.778
08.	TRING.....	4.102.409
09.	Tibo Tv.....	905.161
10.	Tema Tv.....	641.877

1.3 Tatim paguesit më të mëdhenj për vitin 2016

■ **Televizione**

Nr.	Subjekti	Tatim fitimi
01.	Klan.....	45.787.367
02.	ABC News.....	12.213.489
03.	Top Channel.....	9.890.154
04.	Ora News.....	3.541.801
05.	Vizion Plus.....	815.640
06.	News 24.....	685.015
07.	Star Plus.....	569.266
08.	Scan.....	470.818
09.	Report Tv	331.478
10.	UTV Education.....	319.389

■ **Radio**

Nr.	Subjekti	Tatim Fitimi
01.	City Radio Albania.....	2.485.203
02.	Energy.....	1.232.424
03.	Club FM.....	969.761
04.	Radio 1.....	717.888
05.	IN.....	626.028
06.	DJ 96,1.....	380.145
07.	Top Albania.....	324.187
08.	Living	167.650
09.	Alpo	87.274
10.	Radio 7	47.353

■ Kabllorë

Nr.	Subjekti	Tatim fitimi
01.	Inkusat.....	2.780.816
02.	Fier Shegan.....	1.304.631
03.	Sky Elbasan	1.180.162
04.	Tata Junior.....	923.895
05.	Përrenjas.....	741.491
06.	Elbasan Cable.....	663.800
07.	Best Cable.....	552.371
08.	Tele Co.....	482.840
09.	Kucova.....	403.514
10.	J & Pro.....	167.650

■ Shërbime të tjera

Nr.	Subjekti	Tatim fitimi
01.	ABCom 3N1.....	61.478.890
02.	Digitalb.....	40.223.141
03.	Nisatel Tv.....	11.379.253
04.	Abissnet.....	3.604.866
05.	TRING	1.000.219
06.	Next tv.....	865.270
07.	Bleta Tv.....	806.003
08.	Tibo Tv.....	432.926
09.	Ultranet.....	73.020
10.	STV Folk.....	16.733

1.4 Sipas nivelit të aseteve fikse

■ Televizione

Nr.	Subjekti	Asetet fikse
01.	RTSH.....	6.060.470.046
02.	Top Channel.....	2.143.383.405
03.	Klan.....	1.762.296.672
04.	Ora News.....	666.419.946
05.	Scan.....	455.618.195
06.	Vizion Plus.....	335.300.485
07.	News 24.....	273.783.670
08.	Bulqiza.....	90.663.257
09.	In	85.756.991
10.	UTV Education.....	59.098.373

■ Radio

Nr.	Subjekti	Asetet fikse
01.	Top Albania Radio.....	91.337.485
02.	Vlora.....	54.122.429
03.	Nacional.....	35.109.317
04.	Radio Maria.....	24.521.274
05.	Living	23.856.543
06.	4 +.....	23.616.039
07.	Travel.....	21.315.960
08.	Radio 7	21.205.107
09.	Jug	19.847.495
10.	Club FM.....	19.035.985

■ Kabllorë

Nr.	Subjekti	Asetet fikse
01.	M.Devolli.....	71.159.890
02.	Sin Tel.....	51.942.902
03.	Tele Co.....	49.777.018
04.	Lobi.....	42.954.698
05.	Inkusat.....	40.790.955
06.	Envo Compani.....	30.146.668
07.	Kukesi.....	29.077.143
08.	Lezhe.....	28.145.207
09.	Kabllor Digital.....	27.043.489
10.	KL-ED.....	25.217.639

■ Shërbime të tjera

Nr.	Subjekti	Asetet fikse
01.	Albtelecom	25.789.911.000
02.	Digitalb.....	3.455.628.618
03.	ABCom.....	3.416.879.784
04.	TRING	3.381.786.318
05.	Abissnet.....	595.632.174
06.	Nisatel Tv.....	264.147.828
07.	DIGICOM.....	133.743.171
08.	Telesport.....	122.881.321
09.	Ultraset.....	116.236.127
10.	Bleta Tv.....	105.608.641


2. Paraqitja grafike e rezultatit ekonomik dhe vlerës së aseteve fikse

2.1 Shpërndarja e OSHMA-ve sipas rezultatit ekonomik

■ Televizione

Segmenti me përqendrimin më të madh, pra 36% e tyre kanë një fitim në intervalin nga 0 deri në 500,000 lekë ndërsa vetëm 3% e tyre kanë realizuar fitime në intervalin 200 milionë -300 milionë, ndërkohë që 28% e tyre rezultojnë me humbje nga të cilët 7 % e totalit të TV regjistrohen me humbje në intervalin 20 milionë deri në 5 milionë


Shpërndarja e subjekteve TV sipas rezultatit ekonomik (në milion lekë)



Radio

Në lidhje e subjektet radio panorama ndryshon disi, edhe pse intervali me përqëndrim më të madh, 74% e tyre, është i njëjtë me TV- të nga zero në 500 mijë. Ndërkohë që 20% e tyre rezultojnë me humbje dhe vetëm 1% e tyre mund të realizojnë fitime në intervalin 10 – 15 milionë


Shpërndarja e subjekteve radio sipas rezultatit ekonomik (në milion lekë)



Kabllorë

Sikurse shihet nga grafiku i mëposhtëm, numri më i madh i e subjekteve kabllorë, 26%, kanë një rezultat që varion nga 0.2 – 0.5 milion lekë. Ndërkohë që 4% e tyre rezultojnë me humbje dhe vetem 1% e tyre kanë një fitim 300 – 400 milionë lekë


Shpërndarja e subjekteve kabllorë sipas rezultatit ekonomik (në milion lekë)



■ Shërbime të tjera

Në këtë kategori vihet re se numri më i madh i këtyre ofruesve, 22% është me humbje, në intervalin -15 deri -1 milionë lekë. Gjithashtu, vërehet një lloj ndarje proporcionale sipas kategorive në rezultatin ekonomik.

Shpërndarja e subjekteve radio sipas rezultatit ekonomik (në milion lekë)




2.2 Shpërndarja e OSHMA-ve sipas aseteve fikse

■ Televizione

Në grafikun e mëposhtëm tregohet se përqendrimi më i madh i subjekteve TV, 35%, i takojnë segmentit 10 – 50 milionë lekë. Duke u pasuar me 25% të subjekteve që janë përqendruar në segmentin minimal 0 – 1 milionë lekë.

Vetëm 2% e televizioneve është përqendruar në segmentin më të lartë mbi 5000 milionë lekë.


Shpërndarja e TV-ve sipas vlerës së aktiveve fikse (në milion lekë)



Radio

Nga grafiku i shpërndarjes së radiove sipas aseteve fiske shihet se grupimi më i madh, 37% e tyre janë përqendruar në segmentin 1- 10 milionë lekë. Pasohet me 35% të subjekteve në segmentin më të ulët 0 – 1 milionë lekë. Dhe vetëm një përqindje shumë e vogël, 2% i takon segmentit maksimal, 600 – 700 milion lekë.


Shpërndarja e Radiove sipas vlerës së aktiveve fikse (në milionë lekë)



Kabllorë

Në kategorinë e kabllorëve vihet re se pjesa më e madhe e subjekteve janë në segmentin 0 sipas aseteve fikse dhe vetëm 2% janë përqendruar në segmentin 50 – 75 milion lekë.


Shpërndarja e kabllorëve sipas vlerës aktiveve fikse (në milionë lekë)



■ Shërbime të tjera

Shërbime të tjera në 17% të tyre janë përqendruar në segmentin 100 – 200 milionë lekë, ndërsa në nivelin maksimal 20000 – 30000 janë grupuar vetëm 6% e tyre.

Shpërndarja e "Shërbime të tjera" sipas vlerës aktiveve fikse (në milionë lekë)



02. PRONËSIA NË AKTIVITETIN AUDIOVIZIV DHE KONTRIBUTI JASHTË TREGUT

3. E drejta dhe kufizimet e pronësisë për OSHMA-të

Në ligjin 97/2013 janë të përcaktuara dhe të rregulluara të gjitha aspektet që lidhen me pronësisë dhe bashkëpronësinë në transmetimet audio dhe audiovizive. Në rastin e licencave kombëtare, ato u jepen vetëm shoqërive aksionare të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë si objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri, mbajtëse të një licence kombëtare për transmetim audio apo licencë kombëtare për transmetim audioviziv, janë nominative.

Sipas këtyre përcaktimeve ligjore, një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare transmetimi audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se 20 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare të transmetimit audioviziv. Për transmetimet analoge audio lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10 për qind në një shoqëri të tretë kombëtare. Një person i tillë nuk lejohet të marrë licencë transmetimi audio, lokale apo rajonale ose licencë transmetimi audioviziv, lokale apo rajonale.

Në rastin e licencave lokale apo rajonale të transmetimit audio dhe licencave lokale apo rajonale të shërbimit të transmetimit audioviziv, ato u jepen personave juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, me objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë të dytë për transmetim audio lokale apo rajonale. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë transmetimi audiovizive lokale apo rajonale.

Në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" ka dhe shumë aspekte të tjera që duhet të mbajnë parasysh ata që përfshihen në këtë treg, elementë që lidhen me të drejtat dhe kufizimet e pronësisë në OSHMA-të kombëtare apo rajonale e lokale.

3.1 Strukturimi pronësor në tregun audio dhe audioviziv

Në grafikët e mëposhtëm jepen të dhëna mbi strukturën pronësore të OSHMA-ve të ndara në katër grupimet e mëdha: televizione, radio, kabllorë dhe shërbime të tjera. Për secilën prej tyre jepen të dhëna mbi dy tregues kryesorë, nivelin e pjesëmarrjes më një aksioner të vetëm dhe së dyti kur jemi në kushtet e një grupi palësh të lidhura aksionerësh. Të dhënat janë të bazuar në dokumentacionin zyrtar që subjektet kanë deklaruar në zyrat përkatëse të regjistrimit të aktivitetit të tyre, QKR.

Duke bërë një krahasim me strukturimin pronësorë me gjashtëmuajorin e parë të vitit 2016, në të dhënat e mëposhtme dallohet se edhe për periudhën e dytë të këtij viti ndryshimet janë të pandjeshme.

■ Televizione


Nga paraqitja grafike vihet re se rreth 62% e subjekteve televizive rezultojnë në pronësi të një aksioneri të vetëm, ndërkohë që rreth 76 % e këtyre subjekteve rezultojnë me aksionerë mbi 50% të vlerës së aksioneve.

Pamja ndryshon kur futet koncepti i aksionerëve si palë të lidhur (brenda rrethit familjar), ku rreth 69% e këtyre subjekteve zotërohen 100% nga pala e lidhur, dhe 84% e tyre zotërohen nga aksionerë palë e lidhur me mbi 50% të aksioneve.


Pamja ndryshon kur futet koncepti i aksionerëve si palë të lidhur (brenda rrethit familjar), ku rreth 69% e këtyre subjekteve zotërohen 100% nga pala e lidhur, dhe 84% e tyre zotërohen nga aksionerë palë e lidhur me mbi 50% të aksioneve.

Struktura pronësore/Televizione

Një aksioner i vetëm



Grup personash të lidhur




Radio

Në tregun radiofonik ky strukturim është pak më i ndryshëm në përqindje, pasi nga grafikët e mëposhtëm vihet re se rreth 60% e subjekteve evidentohen në pronësi të një aksioneri të vetëm, ndërkohë që 73 % janë me aksionerë mbi 50% të vlerës së aksioneve.


Tek strukturimi i aksionerëve si palë të lidhur, 63% e subjekteve radiofonike zotërohen 100% nga pala e lidhur dhe 78% e tyre zotërohen nga aksionerë palë e lidhur me mbi 50% të aksioneve.

Struktura pronësore/Radio

Një aksioner i vetëm



Grup personash të lidhur




Kabllorë

Në grafikun e mëposhtëm shihet qartë se 83% e subjekteve kabllorë zotërohen nga një aksioner i vetëm, pra me 10% të aksioneve. Ndërsa 88% e kabllorëve zotërohen nga aksionerë me mbi 50% të aksioneve. Në rastin e aksionerëve si palë e lidhur (brenda rrethit familjar) të paraqitur në grafikun e mëposhtëm rezulton se 89% e tyre zotërohen 100% nga pala e lidhur dhe 91% zotërohen nga pala e lidhur me mbi 50% të aksioneve.


Tek strukturimi i aksionerëve si palë të lidhur, 63% e subjekteve radiofonike zotërohen 100% nga pala e lidhur dhe 78% e tyre zotërohen nga aksionerë palë e lidhur me mbi 50%

Struktura pronësore/Kabllorë

Një aksioner i vetëm



Grup personash të lidhur




■ Shërbime të tjera

Tek ky grupim paraqitet një pamje e kundërt e niveleve të treguesve, më të ulët. Kjo pasi jemi në kushtet e aktivitetit të tyre si shoqëri aksionere.


Rreth 40% e subjekteve është në pronësi të një aksioneri të vetëm, ndërkohë që 60 % e tyre janë me aksionerë mbi 50% të vlerës së aksioneve. Si palë e lidhur, 52 % e subjekteve zotërohen 100% nga pala e lidhur, dhe 72% me mbi 50% të aksioneve.

Struktura pronësore/Shërbime të tjera

Një aksioner i vetëm



Grup personash të lidhur



3.2 Përqendrimi i kontributorëve të OSHMA-ve në degë të ndryshme të industrisë


Në grafikët vijues jepen të dhënat kur pronarët dhe aksionerët që janë investuar në tregun audio dhe audioviziv janë të orientuar në aktivitetin e tyre të biznesit edhe në degë të tjera të industrisë, sipas përcaktimeve të INSTAT-it, si psh tek bujqësia, pyjet dhe peshkimi; industria nxjerrëse; industria përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve; ndërtimi; tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorcikletave; transporti magazinimi dhe telekomunikacioni; akomodimi dhe shërbimi ushqimor; hotelet dhe restorantet; informacioni dhe komunikacioni; aktivitete financiare dhe të sigurimit; arsimimi; aktivitete të pasurive të paluajtshme etj.

Edhe për këtë tregues, ndryshimet nga gjashtëmujori i parë në të dytin janë po të pandjeshme.

Televizione


Bazuar në të dhënat e QKR-së, në tregun televiziv pronarët dhe aksionerët që i zotërojnë janë të orientuar më shumë në dy degët e industrisë (grafiku më poshtë), tregtia me shumicë dhe me pakicë me 20 % dhe informacioni dhe komunikacioni me 19%.

- Bujqesia, pyjet dhe peshkimi
- Industria nxjerrëse
- Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar
- Furnizimi me uje, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve
- Ndertimi
- Tregtia me shumice dhe me pakice, riparimi i automjeteve dhe bicikletave
- Transporti, magazinimi dhe telekomunikacioni
- Akomodimi dhe shërbimi ushqimor, hotelet dhe restorantet
- Informacioni dhe komunikacioni
- Aktivitete Financiare dhe të sigurimit
- Aktivitete të pasurive të paluajtshme
- Shërbime administrative dhe mbështetëse
- Administrimi publik dhe mbrojtja; sigurim social i detyrueshem
- Arsimi
- Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale
- Arte, Arëtim, Shlëdhje
- Aktivitete të tjera shërbimi





Radio

Edhe në rastin e radiove, më shumë prej pronarëve dhe aksionerëve janë prezentë po tek tregtia me shumicë dhe me pakicë me 19%, pastaj renditet sektori i aktiviteteve të tjera të shërbimit me 14% dhe me 13% nga informacioni dhe komunikacioni, ndryshe nga televizioni ku niveli i këtij sektori ishte në masën 19%.




Kabllorë

Kontributi në tregti me shumicë dhe me pakicë është domuniues dhe te grupi i pronarëve dhe aksionerëve me 29%, në një kohë që degë tjetër e industrisë është ajo e aktivitete të tjera shërbimi me 20%, akomodimi dhe shërbimi ushqimor, hotele e restorante dhe sektori i ndërtimit janë në kuotat 10%.



■ Shërbime të tjera

Te ky grupim i OSHMA-ve kemi një strukturë të ndryshme të angazhimit të pronarëve dhe aksionerëve të tyre, ku, sikundër shihet nga grafiku më poshtë, orientimi më i madh është tek aktivitetet financiare dhe të sigurimit, 25%, shërbimet kolektive, sociale dhe individuale, po 25% dhe me 24 % në tregtinë me shumicë dhe me pakicë.



03. KARAKTERISTIKA TË PERSONELIT TË ANGAZHUAR NË OSHMA-TË

Rekrutimet dhe menaxhimi i burimeve njerëzore në subjektet audio dhe audiovizive kanë një ndikim të jashtëzakonshëm në larminë dhe cilësinë produkteve dhe shërbimeve që ato ofrojnë. Në këtë seksion jepen disa nga treguesit kryesorë të përbërjes së stafëve si dhe pjesa e trajtimit të tyre në raport me të ardhurat dhe shpenzimet që bëjnë OSHMA-të. Të dhënat që vijojnë bazohen në deklaratimet që kanë bërë vetë subjektet audio dhe audiovizive në institucionet publike përkatëse.

4. Strukturimi i stafëve sipas nivelit arsimor, moshës, vjetërsisë në punë, gjinisë dhe profesioneve.

4.1 Arsimitimi i punonjësve


Nga grafikët e veçantë për televizionet, dhe radiot rishihet se ka ngjashmëri kur vjen puna tek niveli arsimor i punonjësve në të tre grupimet, të atyre që kanë përfunduar vetëm arsimin 8-vjeçar, shkollën e mesme dhe të lartën.

Bie në sy vetëm te televizionet e radiot, të cilat angazhojnë dhe studentë, përkatësisht 2%, ndërsa për kabllorët kjo mundësi nuk ekziston.

Ndërsa për kategorinë e kabllorëve përqindja më e lartë e të punësuarve përkatësisht 65% është me nivelin e arsimit të mesëm.

■ Televizione

- Tetevjecar
- I Mesem
- Student
- I Larte




Radio

Tetevjekar

I Mesem

Student

I Larte




Kabllorë

Tetevjekar

I Mesem

I Larte




4.2 Moshë

■ Televizione

Në televizione grupmosha 30 – 35 vjeç zë peshën më të madhe në stafe me rreth 23%. Dhe ajo që duket qartë nga grafiku është se fuqia më e madhe puntëtore varion prej 25 – 40 vjeç.


Përqindja në ndarjen e grupmoshës për TV



■ Radio

Edhe tek radiot vërehet e njëjta gjë, ku peshën më të madhe të stafit e zë grupmosha 30 – 35 vjeç.


Përqindja në ndarjen sipas grupmoshës për Radiot



Kabllorë

Stafi i anagazhuar në subjektet kabllore ka një përbërje të shpërndarë në mënyrë më të njëjtrajtshme, pa shumë diferenca mes grupmoshave, por ajo që ka peshën më të madhe është grupmosha 31 – 35vjeç dhe 51- 60 vjeç.

Përqindja në ndarjen e grupmoshës për TV




4.3 Vjetërsia në punë

■ Televizione

Nga paraqitja grafike e këtij treguesi tek televizionet vërehet se 40% e stafit është me vjetërsi deri në 3 deri në 5 vjet, gjë që ka ndryshuar nga gjashtëmujori i parë i vitit 2016 ku përqindja më e madhe e stafit ishin deri në 1 vit. Kjo përforcohet dhe nga grafiku më poshtë ku prezantohet struktura e punonjësve me vjetërsi deri në 1 vit, nga e cila del se nga të punësuarit rishtaz vetëm 10% e tyre kanë një vjetërsi 0 – 6 muaj.


Përqindja e stafit sipas vjetërsisë në punë



% Përqindja	Deri ne 1 vit	1-3 vjet	3-5 vjet	5-10 vjet	10-15 vjet	15-25 vjet	25-35 vjet	35-45 vjet
	10%	10%	40%	20%	10%	5%	2%	1%

Deri në 1 vit në punë


- 3-6 muaj
- 6 muaj - 1 vit



Radio

Edhe këtë gjashtëmuor tregohet se tregu radiofonik është pak më i qëndrueshëm ku përqindja më e madhe e stafit, 34% është në segmentin 1- 3 vjet punë dhe 5 – 10 vjet punë 28% e stafit.


Përqindja e stafit sipas vjetërsisë në punë



Kabllorë

Në këtë kategori të OSHMA-ve vërehet se mëse gjysma e numrit të përgjithshëm të stafit ka një vjetërsi 1 – 3 vjet në punë dhe se 31% e këtij stafi janë deri në një vit punë, gjë që tregon qartë paqëndrueshmëri dhe që sjell edhe njëherë në vëmendje shqetësimin e punës pa kontrata në këtë treg.

Përqindja e stafit sipas vjetërsisë në punë




% Përqindja	Deri ne 1 vit	1-3 vjet	3-5 vjet	5-10 vjet	10-15 vjet
	31%	51%	7%	7%	4%

4.4 Balanca gjinore

Porsi në gjashtëmujorin e parë të vitit 2016 evidentohet se tek televizionet mbisundon punësimi i gjinisë femërore me 64%, por ato janë në minorancë në tregun radiofonik, 41%, kurse tek kabllorët shifra është akoma dhe më e ulët, 24%. Raportet meshkuj-femra janë prezantuar në grafikët e mëposhtëm.


■ Televizione

Ndarja gjinore për TV




■ Radio

Raporti gjinor për Radio



■ Kabllorë

Ndarja gjinore për kabllorët





4.5 Struktura sipas profesioneve

■ Televizione

Nga grafiku për tregun televiziv bie në sy se përqindja më e madhe e punonjësve është stafi teknik, 35%, kjo nga vetë natyra e produkteve dhe shërbimeve në këtë grupim të OSHMA-ve. Pastaj vjen stafi gazetaresk me 27% dhe i treti nga pesha specifike në raport me gjithë punonjësit është personeli i shërbimeve të brendshme.


Perberja e stafit ne % sipas profesionit



■ Radio

Në strukturimin e stafit sipas profesionit në subjektet radiofonike më shumë ka gazetarë, 29%, stafi artistik 24% dhe staf teknik me 22%. Këto janë nivele të mesatarizuara për të gjithë tregun, ku në radio të ndryshme përqindjet janë të ndryshme.

Perberja e stafit ne % sipas profesionit




5.5 Struktura sipas profesioneve

Kabllorë

Operatorët kabllorë duke qenë se ofrojnë për abonentët e tyre buketa programesh të ritransmetuara, atëherë dhe pjesa më e madhe e stafit të tyre përfshihet në shërbimet e brendshme, 40%, dhe në sektorin teknik, 28%, ndërkohë që sektori i programacionit është më i vogli me 4%.

Perberja e stafit ne % sipas profesionit




5. Trajtimi i personelit në raport me të ardhurat dhe shpenzimet

5.1 Strukturimi i pagave sipas ndarjes në profesione të stafit

Në grafikët e mëposhtëm pasqyrohen përqindjet e grupimeve të personelit (teknika, shërbimet e brendshme, gazetarët, administrate etj.) dhe përqindjet përkatëse që zë fondi i pagave për secilin prej grupeve në raport me totalin e këtij fondi. Si ilustrim në grafikët është marrë muaji korrik 2016.

■ Televizione

Sikurse shihet nga raportet për secilin nga grupimet kryesore të stafit, tek televizionet vihet re se në përqindje stafet teknike kanë paga më të ulta krahasuar me ekipet gazetareske dhe akoma të ulta se sa pjesa artistike e personelit apo drejtuesit.




■ % e ndarjes se stafit sipas profesionit %

■ % sipas totalit te pagave Korrik

Radio

Tek radiot ky fenomen është më i zbutur kur vjen tek sektori teknik, pasi në këtë gjashtëmujor gazetarët në radio vijnë me paga më të larta. Ekipi artistik ka, gjithashtu, një rritje të nivelit të pagave krahasuar me gjashtëmujorin e parë, kjo edhe si rrjedhojë e produksioneve në atmosferën e festave të fundvitit.




■ % e ndarjes se stafit sipas profesionit

■ % sipas totalit të pagave Korrik

Kabllorë

Nga grafiku i operatorëve kabllorë stafi i shërbimeve të brendshme ka një përqindje më të lartë të fondit të pagave, duke u pasuar nga stafi teknik, kjo për vetë strukturimin e burimeve njerëzore që kanë këto OSHMA që rriten përmbajtje të të tretëve.



■ % e ndarjes se stafit sipas profesionit


■ % sipas totalit të pagave Korrik

6.2 Përqendrimi i personelit të OSHMA-ve sipas nivelit të pagës

Televizione


Duke ju referuar grafikëve të mëposhtëm në kategorinë e subjekteve televizive vihet re se rreth 25% e personelit është në segmentin e nivelit mesatar të pagës nga 23-40 mijë lekë, që përbën dhe përqendrimin më të madh. Ndërkohë që më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të punonjësve paguhet deri në 60 mijë lekë. Në muajin shtator kemi një rritje të nivelit të pagave.

Ndërsa në grafikun hyrje daljeve rishtazi në punë dallohet se numri më i lartë është i largimeve nga puna në muajin dhjetor.



	Nen 22,000	22, 000	23, 000	40, 001	60, 001	80, 001	100, 001	120, 001	140, 001	160, 001	200, 001	250, 001	300, 001	400, 001	1,000, 000
	22,000	22, 523	40, 000	60, 000	80, 000	100, 000	120, 000	140, 000	160, 000	200, 000	250, 000	300, 000	400, 000	800, 000	1,500, 000
% Staf Djeter	2.1%	16.8%	24.5%	21.3%	17.8%	7.5%	3.0%	2.6%	1.5%	1.3%	0.5%	0.7%	0.5%	0.6%	0.3%
% Staf Shtator	1.2%	19.2%	26.5%	23.9%	13.5%	6.2%	2.6%	1.7%	1.4%	1.2%	0.7%	0.6%	0.6%	0.5%	0.2%
% Staf Korrik	1.4%	16.9%	27.0%	24.2%	14.1%	6.7%	2.5%	1.7%	1.3%	1.1%	0.9%	1.0%	0.4%	0.5%	0.3%


Lëvizjet e stafit



Radio

Në tregun radiofonik përqendrimi më i madh i personelit është në nivelin e pagës 40-60 mijë lekë dhe jo si në rastin e mësipërm të televizioneve ku numri më i lartë i punonjësve ishte tek 23-40 mijë lekë. Tregues i njëjtë për dy kategoritë është fakti se edhe te radiot më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të punonjësve paguhet deri në 60 mijë lekë.


Vihet re se në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2016 nuk ka të punësuar në radio, përveç se 6% në dhjetor, në po të njëjtin muaj ku ka dhe largime më tepër, me 11%.



■ % sipas dhjetor
 ■ % sipas shtator
 ■ % sipas korrik

Nen 22,000	22,000 - 22,523	23,000 - 40,000	40,001 - 60,000	60,001 - 80,000	80,001 - 100,000	100,001 - 120,000	120,001 - 140,000	140,001 - 160,000	Te punesuarit rishtazi	Te larguarit rishtazi
2%	15%	21%	23%	11%	6%	3%	3%	2%	6%	8%
3%	16%	22%	29%	12%	7%	3%	2%	1%	1%	4%
5%	16%	23%	29%	13%	6%	4%	2%	1%	1%	0%


Të larguarit rishtazi



Të larguarit rishtazi

Kabllorë

Në rastin e kabllorëve, sipas grafikut respektiv, dallojmë se përqendrimi më i madh i punonjësve është në nivelin e pagesës 22.000 – 22.523 lekë, që është dhe kufiri limit për derdhjen e sigurimeve shoqërore. Ky tregues vjen nga natyra e regjistrimit të këtij lloj biznesi si person fizik, që përgjithësisht derdh nivelin minimal të sigurimeve shoqërore për pesonelin e angazhuar.




■ % Staf dhjetor
 ■ % Staf shtator
 ■ % Staf korrik

■ % Staf dhjetor
■ % Staf shtator
■ % Staf korrik

	Nen 22,000	22,000 22,523	23,000 40,000	40,001 60,000	60,001 80,000	80,001 100,000	100,001 160,000	160,001 200,000	200,001 300,000
% Staf dhjetor	2.1%	68.21%	6.4%	19.7%	0.7%	0.7%	1.19%	0.5%	0.5%
% Staf shtator	2.3%	64.13%	8.8%	20.5%	0.8%	1.8%	0.87%	0.3%	0.5%
% Staf korrik	2.14%	66.68%	8.85%	19.30%	0.54%	0.80%	0.88%	0.27%	0.54%


Lëvizjet e stafit

Lëvizjet e stafit



Të larguarit rishtazi

Të larguarit rishtazi



6.4 Raporti i pagave mbi të ardhurat dhe shpenzimet vjetore totale


Në këtë seksion jepen paraqitjet grafike të shpërndarjes së numrit të OSHMA-ve për segmentet e raporteve të pagave mbi të ardhurat dhe shpenzimet, sipas balanceve të raportuara gjatë vitit 2016, në kategoritë televizione, radio dhe kabllorë.

■ Televizione

Bazuar në të dhënat në tregun e televizioneve, shihet se përqendrimi më i madh i subjekteve, 21% e tyre e kanë raportin e pagave mbi shpenzime totale në segmentin 30- 40%.

Për sa i takon raportit të pagave mbi të ardhura, numri më i madh i subjekteve, 21% përqendrohet tek segmenti 40 – 50%.


Paraqitja e Tv-ve sipas raportit në % të shpenzimeve të personelit mbi totalin e të ardhurave / shpenzimeve



	5-20%	20-30%	30-40%	40-50%	50-60%	60-70%	70-80%	80-90%
% Përqendrimi i TV per raportin paga/te ardhura	14%	9%	21%	14%	12%	12%	12%	6%
% Përqendrimi i TV per raportin paga/shpenzime	12%	14%	14%	21%	16%	9%	7%	7%


Përqendrimi i TV për raportin paga/të ardhura

- 5 - 20%
- 20 - 30%
- 30 -40%
- 40 - 50%
- 50 - 60%
- 60 - 70%
- 70 - 90%
- mbi 90%



Përqendrimi i TV për raportin paga/shpenzime


- 5 - 20%
- 20 - 30%
- 30 -40%
- 40 - 50%
- 50 - 60%
- 60 - 70%
- 70 - 90%
- mbi 90%



Radio

Në këtë kategori bie në sy se grupimi më i madh i subjekteve, 19%, e kanë raportin e pagave mbi te ardhurat vjetore totale në segmentin 20-30%. Ndërkohë që në segmentin 60-70% të raportit të pagave mbi shpenzimet totale vjetore përqëndrohen 29% e subjekteve radiofonike.


Paraqitja e Radio-ve sipas raportit në % të shpenzimeve të personelit mbi totalin e të ardhurave / shpenzimeve



	1-20%	20-30%	30-40%	40-50%	50-60%	60-70%	70-90%	mbi 90%
% e pagave mbi totalin e shpenzimeve	8%	15%	19%	8%	10%	29%	4%	7%
% e pagave mbi totalin e te ardhurave	13%	19%	15%	12%	12%	13%	8%	8%


Përqendrimi i Radiove për raportin paga/të ardhura

- 1 - 20%
- 20 - 30%
- 30 -40%
- 40 - 50%
- 50 - 60%
- 60 - 70%
- 70 - 90%
- mbi 90%



Përqendrimi i Radiove për raportin paga/shpenzime


- 1 - 20%
- 20 - 30%
- 30 -40%
- 40 - 50%
- 50 - 60%
- 60 - 70%
- 70 - 80%
- mbi 90%



Kabllorë

Te operatorët kabllorë përqendrimi më i madh, rreth 48% e kanë raportin e pagave mbi te ardhurat vjetore në segmentin 1-20%. Ndërkohë 40% e tyre, janë po në këtë segment edhe kur vjen puna te raporti i pagave mbi shpenzimet vjetore totale.

Paraqitja e Radio-ve sipas raportit në % të shpenzimeve të personelit mbi totalin e të ardhurave / shpenzimeve




■ % e pagave mbi totalin e shpenzimeve

■ % e pagave mbi totalin e te ardhurave

	5-20%	20-30%	30-40%	40-50%	50-60%	60-80%	80-90%
% e pagave mbi totalin e shpenzimeve	40%	26%	15%	10%	4%	2%	3%
% e pagave mbi totalin e te ardhurave	48%	18%	18%	9%	2%	2%	3%


Përqendrimi i Kabllorëve për raportin paga/të ardhura

- 1 - 20%
- 20 - 30%
- 30 - 40%
- 40 - 50%
- 50 - 60%
- 60 - 80%
- 80 - 90%



% e shpenzimeve për paga / totali i shpenzimeve

- 1 - 20%
- 20 - 30%
- 30 - 40%
- 40 - 50%
- 50 - 60%
- 60 - 80%
- 80 - 90%



04. TREGUESIT TEKNIKË TË TRANSMETIMIT TË OSHMA-VE

Një OSHMA e licencuar/autorizuar nga AMA respekton kushtet e mbulimit me sinjal në territorin e përcaktuar. Në ligjin 97/2013 përcaktohet se mbulimi i përgjithshëm është mbulimi nga një shërbim pa pagesë i transmetimit për të paktën 95 për qind të popullsisë në Republikën e Shqipërisë. Autoriteti Rregullator në zbatim të këtij ligji merr në konsideratë gjatë procesit të licencimit/autorizimit të subjekteve kombëtare se ato duhet të mbulojnë me sinjal jo më pak se 80 për qind e territorit të vendit.

Për Transmetuesin Publik, RTSH-në përcaktohet se programet e saj duhet të mbulojnë territorin e banuar nga të paktën 90 për qind e shtetasve të Republikës së Shqipërisë. Brenda prillit të vitit 2018, të paktën njëri nga rrjetet e RTSH-së duhet të mbulojë 99 për qind të popullsisë.

6. Plani frekuencor numerik

Plani i frekuencave për transmetime numerike në Shqipëri, është miratuar në marrëveshjen e Gjenevës 2006 (GE06) me aktet finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve "Për planifikimin e transmetimeve numerike tokësore në pjesë të rajoneve 1 dhe 3 në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06)". Aktet finale të Konferencës GE 06 janë ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me ligjin nr. 9851 datë 26.12.2007.

Bazuar në aktet e mësipërme, ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 2.05.2012 "Për miratimin e Strategjisë së Kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike", AMA ka miratuar frekuencat për 7 rrjetet numerike kombëtare, nga të cilët 2 rrjete i përkasin operatorit publik shqiptar (RTSH) dhe 5 rrjete operatorëve privatë numerikë kombëtarë.

Plani Frekuencor Numerik parashikon edhe një mbulim kombëtar në brezin VHF si dhe mbulime rajonale/lokale (në suballotmentin e Tiranës dhe në allotmentet e tjera). Për të realizuar këto mbulime do të përdoren frekuencat e mbetura të lira të cilat paraqiten në tabelën më poshtë.

Në përmbushje të detyrave të përcaktuara në ligjin 97/2013 dhe strategjinë për kalimin në transmetimet numerike, AMA ka ndërmarrë aktivitete të rëndësishme gjatë periudhës qershor-dhjetor 2016 ndër të cilët do të listonim:

- Licencimin e 4 operatorëve privatë kombëtar numerikë (Top Channel, Klan, Digitalb dhe Media Vizion) .
- Koordinimin me operatorin publik shqiptar në lidhje me implementimin e dy rrjeteve numerike, si dhe zbatimin e detyrimeve ligjore dypalëshe.
- Koordinimin me operatorët privatë kombëtarë të licencuar për transmetime numerike, lidhur me zbatimin e afateve të implementimit të rrjeteve të tyre numerike sipas përcaktimeve në licencat që ato zotërojnë, procesin e lirimit të frekuencave që përdornin në mënyre të jashtëligjshme, procesin e migrimit të frekuencave, si dhe përcaktimin e kushteve dhe kritereve për mbështetjen në rrjetet e tyre të operatorëve lokalë/rajonale.
- Koordinimin me operatorët analogë lokalë/rajonale lidhur me afatet kohore të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi për mbështetjen e tyre në rrjetet kombëtare numerike.
- Intensifikimin e fushatës informuese për t'iu gjendur pranë publikut deri në perfundim të procesit të digjitalizimit, fushatë e cila është organizuar në forma të ndryshme për të qenë sa më efektive dhe depërtues tek publiku shqiptar (spote televizive, broshura, fletëpalosje, struktura Call Center, emisione televizive etj)

Në vijim të aktiviteteve të ndërmarra nga AMA u arrit që operatori publik shqiptar (RTSH) të shtrijë infrastrukturën numerike pothuajse në të gjithë vendin, si dhe të fillojë transmetimet numerike në qarqet Tiranë, Durrës përkatësisht më datë 01.12.2016.

Në aneksin vijues paraqitet Plani Frekuencor Numerik për dy rrjetet kombëtare publike dhe 5 rrjetet kombëtare private, si dhe identifikohen kanalet e lira frekuencore për licencimin e operatorëve lokalë/rajonale.

Lirimi i brezit 790-862 MHz (Dividendit Digjital): AMA ka ndërmarrë disa hapa për lirimin e brezit DD1 ku do të theksonin:

- Lirimin e këtij brezi nga transmetimet e paligjshme.
- Migrimin e operatorëve që kishin në përdorim frekuencat e brezit DD1 në frekuenca të tjera poshtë këtij brezi.
- Takime me operatorët audiovizivë në kuadër të përsheptimit të procesit dhe zgjidhjes së problematikave të hasura.
- Monitorime të vazhdueshme për të verifikuar situatën në terren lidhur me lirimin e frekuencave të brezit DD1.

Interferencat e shkaktuara në vendet fqinje: Gjatë periudhës qershor-dhjetor 2016, shqetësim i vazhdueshëm i AMA-s kanë qenë interferencat e shkaktuara në brezin 790-862 MHz (DD1) nga operatorët audiovizivë shqiptarë drejt operatorëve mobilë të vendeve fqinje.

Ankesat e ardhura nga Italia dhe Mali i Zi dhe vendet e tjera fqinje janë trajtuar me prioritet nga AMA duke mundur eliminimin e interferencave të shkaktuara.

²Në muajin janar 2017 licensohet dhe rrjeti i fundit kombëtar privat numerik (MUX7).

Plani Frekuencor Numerik për 2 rrjetet kombëtare publike të RTSH-së në Rep.Shqiperise (i miratuar nga AMA me V. nr. 27, datë 01.02.2013).

RRJETET PUBLIKE	AL-001D	AL-002D	AL-003D	AL-004D	AL-005D	AL-006D	AL-007D	AL-008D	AL-009D	AL-010D	AL-011D
	Shkodër	Kukës	Dibër	Lezhë	Tiranë	Elbasan	Fier	Berat	Korçë	Gjirokastër	Vlorë
RTSH(MUX-1)	28	26	38	43	34	23	27	25	43	26	23
RTSH(MUX-2)	41	32	24	23	21	33	31	30	45	37	39

Plani Frekuencor Numerikë për 5 rrjetet kombëtarë privatë në brezin UHF në R.SH

RRJETET KOMBËTARE PRIVATE	AL-001D	AL-002D	AL-003D	AL-004D	AL-005D	AL-006D	AL-007D	AL-008D	AL-009D	AL-010D	AL-011D
	Shkodër	Kukës	Dibër	Lezhë	Tiranë	Elbasan	Fier	Berat	Korçë	Gjirokastër	Vlorë
Rrj.1 TVSH(MUX-3)	34	50	55	33	41	42	35	32	51	44	46
Rrj.2 TVSH(MUX-4)	59	40	30	46	53	48	28	36	55	29	57
Rrj.3 TVSH(MUX-5)	45	42	25	29	59	49	22	54	57	50	43
Rrj.4 TVSH(MUX-6)	22	36	54	-	57	46	29	24	21	48	-
Rrj.5 TVSH(MUX-7)	51	52	60	-	39	40	45	47	27	35	-

Kanalet frekuencore te lira ne brezin VHF dhe UHF

	AL-001D	AL-002D	AL-003D	AL-004D	AL-005D	AL-006D	AL-007D	AL-008D	AL-009D	AL-010D	AL-011D	Suballotment
	Shkodër	Kukës	Dibër	Lezhë	Tiranë	Elbasan	Fier	Berat	Korçë	Gjirokastër	Vlorë	Tiranë
Kanalet e lira në VHF	9	9	8	9	10	7	10	5	6	8	8	6
Kanalet e lira në UHF		56				56	51	52	28	38		26
						58			59	53		37
										56		44
										58		50
										60		60

7. Mbulimi me sinjal i OSHMA-ve sipas territorit dhe popullatës


7.1 Paraqitja e hartave gjeografike për subjektet kombëtare

Bazuar në hartat e mëposhtme, të dy brezave frekuencorë të TVSH-së, Top Channel, Klan, Radio Tirana dhe Top Albania Radio, tregohen nivelet e mbulimit të operatorëve kombëtarë në territoret ku ky tregues është 60-100% (kjo është hapësira më e madhe), pastaj vjen 20-60% dhe 0-20%.

OPERATORI PUBLIK TELEVIZIV TV SHQIPTAR

BREZI VHF (174-230) MHz

Në hartë, mbulimi me sinjal



**OPERATORI PUBLIK TELEVIZIV
TV SHQIPTAR**


**BREZI VHF
(470-862) MHz**

Në hartë, mbulimi me sinjal

- Mbulimi me sinjal (0-20) %
- Mbulimi me sinjal (20-60) %
- Mbulimi me sinjal (60-100) %
- Mbulimi i zones se autorizuar
- Stacion Transmetues

Shenim: 1.Llogaritjet jane bere per nje nivel minimal te sinjalit 50 dBuV/m

2.Mbulimi i referohet territorit



OPERATORI KOMBETAR TELEVIZIV TV KLAN

Në hartë, mbulimi me sinjal sipas licensimit

Zona e Licencimit:
Republika e Shqiperise


Territori 53.9%
Popullsia 78%

79.0%

- Mbulimi me sinjal (0-20) %
- Mbulimi me sinjal (20-60) %
- Mbulimi me sinjal (60-100) %
- Mbulimi i zones se autorizuar
- Stacion Transmetues

Shenim: 1.Llogaritjet jane bere per nje nivel minimal te sinjalit 50 dBuV/m

2.Mbulimi i referohet territorit



OPERATORI PUBLIK RADIO RADIO TIRANA


Në hartë, mbulimi me sinjal

80.54%

- Mbulimi me sinjal (0-20) %
- Mbulimi me sinjal (20-60) %
- Mbulimi me sinjal (60-100) %
- Mbulimi i zones se autorizuar
- Stacion Transmetues

Shenim: 1.Llogaritjet jane bere per nje nivel minimal te sinjalit 50 dBuV/m

2.Mbulimi i referohet territorit



OPERATORI KOMBETAR RADIO RADIO TOP ALBANIA


Në hartë, mbulimi me sinjal sipas licensimit

Zona e Licencimit:
Republika e Shqipërisë

- Mbulimi me sinjal (0-20) %
- Mbulimi me sinjal (20-60) %
- Mbulimi me sinjal (60-100) %
- Mbulimi i zones se autorizuar
- Stacion Transmetues

Shenim: 1.Logaritjet jane bere per nje nivel minimal te sinjalit 50 dBuV/m

2.Mbulimi i referohet territorit




8.2 Mbulimi sipas qarqeve

Tabela dhe grafiku në vijim tregojnë shpërndarjen territoriale të OSHMA-ve. Përqendrimi më i madh i tyre është në qarkun e Tiranës, 16% e televizioneve, 31% e radiove, 8% e kabllorëve dhe 13% shërbime të tjera. Më pas vijojnë Vlora dhe Fieri dhe të fundit janë Kukësi dhe Dibra. Megjithatë sipas grupimeve të ndryshme, variojnë dhe përqëndrimet në qarqe, psh sikundër shihet nga të dhënat, më shumë televizione, pas Tiranës, ka në Vlorë, Fier dhe Elbasan, kurse përqendrimi i radiove, pas Tiranës, është më shumë në qarkun e Vlorës, Fier, Korçë e Elbasan, ndërkohë që për kabllorët sipas renditjes me përqindje më shumë ka në Fier, pastaj në Korçë, Elbasan, Berat etj. Përsa i përket shërbimeve të tjera

QARKU	Nr. TV	Nr. Radio	Nr. Kabllorë	Nr. Shërbime të tjera
Berati	6	1	12	5
Dibra	4	1	5	6
Durrësi	11	3	5	8
Elbasani	16	10	16	7
Fieri	16	15	20	8
Gjirokastra	5	4	4	7
Korça	8	11	18	6
Kukësi	3	-	3	6
Lezha	13	1	5	7
Shkodra	12	8	2	9
Tirana	21	36	9	12
Vlora	16	28	8	10

Përqëndrimi i OSHMA-ve sipas qarqeve



	Berat	Dibër	Durrës	Elbasan	Fier	Gjirokastër	Korçë	Kukës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë
Sherbime te tjera %	5%	7%	9%	8%	9%	8%	7%	7%	8%	10%	10%	11%
Kabllore ne %	11%	4%	8%	13%	18%	3%	14%	2%	5%	4%	8%	10%
Radio ne %	1%	1%	2%	9%	14%	5%	11%	0%	1%	4%	29%	23%
TV ne %	5%	3%	10%	13%	12%	4%	5%	2%	6%	12%	16%	12%


7.3 Mbulimi sipas numrit të popullatës

